

FORMULARI NUMËR 3

KONCEPTDOKUMENTI PËR KRYEPROKUROR

Emri:	Zef
Mbiemri:	PRENRECAJ

Bazuar në kompetencat ligjore të parapara për pozitën që aplikoni, ju lutem të ofroni si vijon:

I. Analizën tuaj:

1. Si e vlerësoni gjendjen aktuale në Prokurorinë e Shtetit?

Puna e Prokurorit të Shteti ka qenë sfiduese në faza të ndryshme dhe me kalimin e kohës ka pasur ndryshime ligjore. Këto ligje janë ndryshuar, janë plotësuar dhe janë përshtatur praktikave më të mira ndërkombëtare. Me kalimin e viteve është arritur të sigurohen dhe të përmbushet kuadri me resurse të nevojshme njerëzore. Është bërë progres i mirë në aspektin e planifikimit dhe përmirësimit të kushteve të punës. Është arritur progres i mirë për trajtimin e rasteve të ndjeshme në mënyrë që besimi i qytetarëve në punën e Prokurorit të Shtetit të rritet. Por, për rritjen në një standardi sa më të mirë duhet punë e vazhdueshme. Prokurori i Shtetit vepron si Organ i pavarur dhe Kushtetuta dhe korniza ligjore aktuale e mundëson të veproj në mënyrë të pavarur. Reformat në sistemin prokurorial janë të nevojshme sepse duhet të ngritët integriteti dhe duhet të ketë siguri juridike për punën e prokurorëve dhe kushtet e punës së tyre duhet të përmirësohen. Prokurori i Shteti konsideroj se, është përkrahur vazhdimisht nga partneret ndërkombëtar. Prokurori i Shtetit ka avancuar bashkëpunimin me autoritetet e shteteve të tjera sa i përket ndjekjeve penale, përmes shkëmbimit të informacionit dhe mënyrave të tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe marrëveshjet ndërkombëtare lidhur mes Kosovës dhe vendeve të tjera. Prokurori i Shteti ka përcaktuar dhe do të përcaktoj plane pune të detajuara që përmirësojnë dukshëm proceset e punës dhe të rrisin integritetin në sistemin prokurorial, profesionalizmin dhe llogaridhënien e prokurorëve.

2. Si e vlerësoni gjendjen aktuale në prokurorinë për të cilën keni aplikuar?

Gjendja aktuale e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, nuk është e dëshiruara. Kam punuar disa muaj në këtë Prokurori dhe përkundër vullnetit dhe kontributit të prokurorëve dhe stafit tjetër për të kryer punën me profesionalizëm, kjo gjendje nuk është siç duhet dhe meriton të jetë. Objekti me qira që disa vite. Ndërtesë private. Ky objekt nuk plotëson nevojat e prokurorisë sepse nuk jep qasje në drejtësi. Objekti aktual nuk ka hapësira të mjaftueshme dhe nuk ka parking të duhur. Ka numër të

pamjaftueshëm të prokurorëve për shkak të gjendjes së krijuar me largimin e prokurorëve të nacionalitetit serb. Nuk ka numër të mjaftueshëm të stafit profesional dhe administrativ. Ka numër të madh të lëndëve të grumbulluara ndër vite. Seanca gjyqësore caktohen shumë dhe prokuroria nuk ka numër të mjaftueshëm të prokurorëve për të përfaqësuar në këto seanca. Kjo ndikon drejtpërdrejtë në profesionalizëm sepse një prokuror obligohet të marr pjesë në disa seanca brenda ditës ku ka më shumë gjyqtar dhe ndarjen e drejtësisë në këto raste nuk mund të jetë shumë profesionale. Kjo kërkon zgjidhje të shpejt. Një gjendje e tillë, kërkon plan veprimi të analizuar mirë dhe të detajuar për të zgjidhur këtë situatë e cila po vazhdon që disa vite.

Në aspektin organizativ dhe funksional, përparësitë e sistemit prokurorial janë si në vijim:

- Pavarësia dhe paanshmëria e sistemit prokurorial, të garantuara me Kushtetutë;
- Organizimi, funksionimi dhe kompetencat, të përcaktuara me ligj;
- Legjislacioni sekondar është i përfunduar dhe është në fazën e rishikimit bazuar në analizat dhe vlerësimet e punës;
- Numri i prokurorëve dhe stafit mbështetës është rritur në mënyrë të konsiderueshme, ndërsa politikat për avancim profesional janë të nivelit të avancuar;
- Sistemi i rekrutimit, avancimit, transferimit dhe disiplinimit funksional ka dhënë rezultate pozitive;
- Sistemi i futjes së të dhënave, përpunimit dhe raportimit bazohet kryesisht në teknologjinë informative;
- Planikimi i buxhetit dhe infrastruktura bazike janë në gjendje të qëndrueshme për të garantuar funksionalitet të plotë dhe
- Bashkëpunimi i mirë me institucione vendore dhe ndërkombëtare, përfshirë donatorët;

Për të garantuar sukses në luftën e përbashkët kundër krimit dhe korrupsionit, ka ende shumë për të bërë dhe për këtë nevojitet bashkëpunimi ndërinstytucional i të gjithë aktorëve të sistemit të drejtësisë penale dhe i strukturave shtetërore, bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë dhe rritja e përgjegjshmërisë dhe integritetit në çdo hallkë të sistemit të drejtësisë.

3. Cilat janë mangësitë dhe sfidat kryesore të kësaj prokurorie?

Në këtë drejtim mangësitë dhe sfidat kryesore ne PTH Mitrovicë, janë vlerësuar si më poshtë:

- Nevoja për riorganizim dhe ngritje të kapaciteteve të resurseve aktuale për planifikim dhe mbikëqyrje të proceseve të punës;
- Mungesa e një analize dhe vlerësimi gjithëpërfshirës për funksionimin e Prokurorisë;
- Mos identifikimi i faktorëve që ndikojnë në rezultatet e punës dhe kushtet jo të mira të punës për shkak të hapësirës jo të mjaftueshme (Objekti me qira i cili nuk plotëson sa duhet kushte);
- Mungesa e buxhetit për ekspertiza dhe trajnime të ndryshme;
- Prezantimi i pamjaftueshëm i rezultateve të punës para publikut, mediave dhe shoqërisë civile;
- Inpute të pamjaftueshme për përcaktimin e politikave afatshkurtra dhe afatmesme;
- Kërkesat për specializime në trajtimin e krimeve specifike dhe,
- Rritja e besimit të publikut.

4. A mendoni se strategjitë aktuale të sistemit adresojnë nevojat e prokurorisë për të cilën aplikoni si Kryeprokuror?

Sistemi i drejtësisë, në përgjithësi dhe sistemi gjyqësor dhe prokurorial, në veçanti, kanë kaluar nëpër reforma të shumta. Sistemi prokurorial për vite me radhë është ballafaquar me numër në rritje të lëndëve dhe numër të pamjaftueshëm të prokurorëve dhe stafit administrativ. Largimi i prokurorëve serb nga puna në Mitrovicë, ka rritur vonesat në trajtimin e lëndëve. Si rezultat, është rritur numri i lëndëve të vjetra dhe detyrimisht ka pasur vonesa në kryerjen e tyre. Andaj, raportet vendore dhe ndërkombëtare kanë vlerësuar se sistemi prokurorial është në fazë të hershme të konsolidimit dhe progresi i duhur ende është larg. Në këtë kontekst është rekomanduar që të ndërmerren masa konkrete për fuqizimin e pavarësisë, paanësisë, integritetit, llogaridhënies, efikasitetit, transparencës dhe profesionalizmit të sistemit prokurorial. Strategjitë aktuale të sistemit adresojnë nevojat- politikat e institucionit dhe menaxhmentit të tij, krahasuar me strategjitë dhe kornizat e politikave të institucioneve në nivel shtetëror, ngaqë koordinimi i tillë siguron një planifikim të drejtë dhe të saktë, si dhe është garantues i rezultateve pozitive. KPK-ja dhe PSH do të punojnë që Prokuroria Themelore e Mitrovicë si prokuroria me nevoja më të mëdha, t'i përcaktojë prioritetet dhe kriteret për shqyrtimin e lëndëve të ndjeshme dhe të korrupsionit dhe në këtë kontekst synohet që të forcohet struktura e saj

përmes profilizimit të prokurorëve, adresimit të nevojave për ngritje të kapaciteteve profesionale, numrit të nevojshëm të prokurorëve dhe personelit, fuqizimit të bashkëpunimit me institucione vendore dhe ndërkombëtare në mbledhjen dhe shkëmbimin e informatave dhe provave për trajtimin e rasteve në kompetencë të kësaj prokurorie.

II. Vizioni juaj për përmirësimin e punës operative në prokurorinë që keni aplikuar?

Ju lutem listoni/përmendni veprimet tuaja afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata:

1. Cili është vizioni juaj për të përmirësuar punën operative gjatë mandatit tuaj?

Vizioni do të jetë qasja e re në funksionimin e Prokurorisë, duke e bërë një Prokurori model për vendin. Punët do të fillojnë me një plan të detajuar. Plani do të ketë të listuar të gjitha veprimet dhe punët operative duke përfshirë edhe afatet. Vizioni do të jetë trajtimi i barabartë për të gjithë para ligjit, efikasitet, efektivitet, transparencë dhe llogaridhënie. Në secilin rast dhe gjithë do të veprohet me paanshmëri dhe në mënyrë të pavarur dhe profesionale, duke mënjanuar ndikimet e brendshme dhe të jashtëm.

2. Cilat janë objektivat tuaja kryesore?

Objektivat kryesore do të jenë:

- 1. Rritja e cilësisë në administrimin e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë,**
- 2. Efikasiteti në trajtimin dhe kryerjen e lëndëve të grumbulluara dhe,**
- 3. Hetimi me prioritet i rasteve të korrupsionit.**

Këto objektiva do të arrihen përmes një plani të punës, i cili do të detajuar dhe nuk do të parasheh:

- Krijimi i kushteve për punë (objekti i ri, etj..).
- Sigurimi i numrit të mjaftueshëm: Prokuror, Staf profesional dhe teknik.
- Aftësim adekuat profesional për gjithë stafin e Prokurorisë.
- Administrimi efikas dhe efektiv..
- Hetimi dhe ndjekja me sukses e kryerësve të veprave penale të gjitha llojeve dhe me theks të veçantë hetimi me prioritet i rasteve të korrupsionit.
- Efikasiteti në trajtimin e rasteve.

- Bashkëpunimin ndërinstitucional.
- Përdorimin e Sistemit SMIL nga gjithë stafi.
- Zbatimi me efikasitet i procedurave alternative.
- Zbatimi me efikasitet i procedurave të sekuestrimit dhe konfiskimit.
- Hetimi me efikasitet dhe efektivitet i rasteve, krimeve ekonomike, krimeve kibernetike, dhunës në familje dhe krimeve të urrejtjes.
- Hetimi me prioritet i rasteve të dhunës në familje dhe të krimeve që kanë të bëjnë me urrejtje, etj..

3. Cilat janë sfidat që prisni gjatë përmbushjes së këtyre objektivave?

Sfidë do të jetë:

- Buxheti;
- Ndërtimi i një objekti të ri - Prokuroria Themelore në Mitrovicë.
- Lëndët e vjetra të grumbulluara.
- Zgjidhja e lëndëve që kanë prioritet ligjor dhe rasteve të korrupsionit.
- Numri i pa mjaftueshëm ose i vogël me prokuror, staf profesional, administrativ dhe teknik.
- Aplikimi i SMIL -it.
- Aplikimi i procedurave alternative, procedurave të sekuestrimit dhe konfiskimit.
- Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar.
- Qasja e mjaftueshme në drejtësi/Prokurori për të gjithë pa dallime.
- Kryerja me prioritet e rasteve - lëndëve, duke marr parasysh numrin e pamjaftueshëm të prokurorëve dhe stafit profesional e administrativ, etje...

4. Si do t'i tejkalojnë ato?

Tejkalojnë duke vepruar si vijon:

- Duke siguruar buxhetin e nevojshëm.
- Duke treguar efikasiteti, efektiviteti dhe profesionalizimi në punë.
- Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së punës;
- Zvogëlimin e numrit të lëndëve të grumbulluara nder vite.
- Integriteti etike dhe profesional.
- Bashkëpunimi i mirë me KPK dhe ZPSH.
- Përkrahja financiare urgjente dhe vazhdueshme nga KPK, ZKSH, SKPK, MD, MF dhe Qeveria.
- Rritja e numrit të prokurorëve, stafit profesional dhe administrativ.
- Përkrahja nga Institucionet ndërkombëtare në Kosovë dhe Jo vetëm.
- Ofrimi i trajnimeve të vazhdueshme për Prokuror, staf profesional, etj...
- Krijimi i kushteve të mira të punës për të punësuarit dhe jo vetëm.
- Ofrimi i qasjes sa më të lehtë për të gjithë në Prokurori.
- Bashkëpunimi me institucionet tjera vendore, shoqërinë civile, medie, etj...
- Bashkëpunimi me Polici, Dogana, IPK, NJF AKK, ATK etj..
- Bashkëpunimi me Institucione dhe organizatat ndërkombëtare në Kosovë UNDP, Ambasada Amerikane, Eulex, Ambasadat tjera, OSBE, BE, etj.. dhe jo vetëm.

III. Vizioni për të menaxhuar personelin në sistemin prokurorial

Ju lutem renditni hapat konkretë që do t'i ndërmerrnit gjatë mandatit tuaj:

1. Cili është modeli juaj në menaxhimin e stafit?

Modeli për të menaxhuar personelin do të bëhet përmes planit të punës, por nuk kufizohet si vijon:

- Vlerësimi i gjendjes aktuale me personel.

- Vlerësimi i kushteve të punës në Prokurori dhe personel.
- Shikimi dhe rishikimi i strukturës organizative të personelit.
- Sigurimi i buxhetit për të menaxhuar në mënyrën më të mirë personelin.
- Hartimi i planit të menaxhimit të personelit.
- Planifikimi dhe administrimi i buxhetit për personel.
- Ngritja e kapaciteteve me burime njerëzore në koordinim dhe bashkëpunim me KPK, ZKSH, SKPK dhe jo vetëm.
- Trajnimi i personelit në mënyrë të vazhdueshme.
- Sigurimi i kushteve të punës për personelin.
- Vlerësimi i rezultateve të punës në baza javore, mujore dhe vjetore.
- Llogaridhënia.

2. Si planifikoni ndarjen e barabartë të punës për stafin?

Ndarja e barabartë do të bëhet:

Sistemi SMIL lëndët i ndan barabartë.

Duke aplikuar sistemin SMIL, Rregulloren për ndarjen e lëndëve dhe rëndësinë e secilit sektor – departament lëndët ndahen barabartë. Pra, do të ndahen lëndët në mënyrë elektronike dhe manuale, por në mënyrë transparente dhe të barabartë. Kur ndahen lëndët në mënyrë manuale përgjegjësi i shkrimoreve do të kujdeset që rastet duhet të ndahen në mënyrë të barabartë dhe duke mbajtur një listë të renditjes për ndarjen e lëndëve sipas rregullit të përcaktuar.

3. Si planifikoni të përmirësoni llogaridhënien dhe profesionalizmin e stafit?

Duke qenë se, qëllim kryesor është mirëfunksionimi i Prokurorisë, stafi duhet të ju përmbahen rregullave sa i përket llogaridhënies dhe profesionalizmit. Llogaridhënia dhe profesionalizmi janë pjesë shumë e rëndësishme e parimeve bazë të cilat e karakterizojnë punën e Prokurorisë. Personeli pa përjashtim janë të obliguar të respektojnë Kushtetutën dhe ligjin dhe të mbrojnë interesin e shtetit dhe të drejtat dhe liritë e njeriut. Kërkohet që stafi profesional dhe administrativ të ushtron detyrën e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës. Stafi ka për obligim të veprojnë në përputhje

me urdhrat e marrë nga mbikëqyrësi i tij (Administratori) sipas ligjit dhe rregullave të brendshme të Prokurorisë.

Në funksion të përmirësimit të llogaridhënies dhe profesionalizimit duhet takuar secilin pjesëtar të stafit për të dëgjuar opinionet, kërkesat, propozimet, rekomandimet rreth punës së përditshme në Prokurori. Në këtë mënyrë mund të detektohen - mësohen problemet apo vështirësitë dhe kjo ndihmon për të përmirësuar profesionalizimin dhe llogaridhënien. Stafit duhet t'i ofrohen kushtet sa më të mira të punës dhe mos të ju mungoj asgjë për të kryer detyrat e punës. Në planifikim do të kërkoja një sistem të vlerësimit të punës së stafit. Vlerësimi duhet të bëhet i rregullt dhe sipas nevojave në rastet kur konsiderohet performancës e dobët. Stafit duhet dhënë mundësi që të përmirësojnë aftësitë profesionale për vendin e punës nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme. Është shumë të nevojshëm trajnimin e administratës të prokurorisë për t'i kryer shërbimet teknike-administrative në mënyrë sa më profesionale. Përmirësimi arrihet përmes Planifikimit dhe mundësisit të trajnimeve për stafin në prokuroritë brenda Kosovës dhe jashtë vendit, me qëllim që stafi të merr praktikën më të mira të vendeve tjera. Për trajnimet duhet mbajtur evidencë për gjitha trajnimet e vijuara, materialet dhe përvojat nga secili pjesëtar i stafit, i cili do të ketë për obligim që pas trajnimit të t'i përdor apo aplikoj ato praktika në punën e tij/saj të përditshme.

IV. Hapat që do të ndërmerrni për përmirësimin e integritetit dhe llogaridhënies së sistemit, prokurorisë dhe besimit të publikut?

Ju lutem listoni/përmendni veprimet tuaja afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata:

1. Çfarë hapash do të ndërmerrni për të ngritur nivelin e besueshmërisë në Prokurorinë tuaj, duke vënë baraspeshë mes transparencës dhe konfidencialitetit të procedurës?

Për të ngritur nivelin e besueshmërisë, duhet vepruar drejt dhe me transparencë në secilin rast. KPK ka rregulluar kornizën ligjore dhe nënligjore që rregullon funksionimin e sistemit prokurorial sa i përket transparencës dhe konfidencialitetit të procedurës. Po ashtu, KPK ka rregulluar të drejtën e opinionit për tu informuar, liritë, të drejtat dhe privatësinë e të gjitha palëve në procedurën penale. Komunikimi me media dhe me palët është i domosdoshëm dhe i një rëndësie të veçantë. Për të rritur transparencën dhe besueshmërinë do të organizojmë takime me palët, të paktën një herë në javë. Do të organizojmë së paku një herë në javë takim me shoqërinë civile. Shoqëria civile mund të përkrahin çështje të caktuara me interes për qytetaret në mënyrë që qasja e tyre në drejtësi të lehtësohet. Takimet, konferencat dhe Publikimi i njoftimeve përmes ueb faqes së KPK-së, do të jenë format më të aplikueshme të komunikimit. Edhe në rastet e kërkesave me pyetjeje, janë forma të komunikimit që do të aplikohen për të ngritur besueshmërinë në punë e Prokurorisë. Në secilin rast veç e veç do të vlerësohet dhe analizohet ekuilibri në mes të

transparencës dhe interesit të hetimit para se informacioni të ndahet me publikun/opinionin. Kujdes i veçantë di t'i kushtohet rasteve me të mitur. Konfidencialiteti i procedurës do të respektohet gjithmonë. Vetëm në rastet e parapara me ligj dhe aktet tjera nënligjore do të epet/publikohet informacion për rastet me interes për palët, opinionin etj..

2. Cilat janë planet tuaja për të siguruar punë cilësore në Prokurorinë tuaj?

Cilësia në punë rritet duke përgatitur një plan operacione për mirë funksionim. SKPK i KPK-së duhet të ofroj mbështetje për ndërtimin e Objektivit të Prokurorisë në Mitrovicë, i cili konsiderojmë se, duhet ndërtuar i ri sepse nuk i plotëson nevojat e punës dhe nuk ofron qasje në drejtësi/prokurori për të gjithë. Nuk ka hapësirë të mjaftueshme. Puna cilësore në Prokurori do të sigurohet duke menaxhuar me sukses punët, duke bërë shpërndarjen e punëve dhe duke kërkuar llogaridhënie. Fillimisht duhet analizuar punën e deritashme dhe pas vlerësimit të kësaj pune, duhet hartuar plani i veprimit për të përmirësuar punën dhe për ta bërë sa më cilësore. Sipas planit të veprimit, si udhëheqës do të kërkojmë nga KPK të caktoj disa përgjegjës të departamenteve përkatëse. Do të krijojmë një kabinet për të mirë funksionuar. Ndarja e përgjegjësive tek përgjegjësit e departamenteve dhe pjesëtarët e kabinetit, do të arrijmë të kontrollojmë edhe kualitetin e të gjitha akteve dhe veprimeve nga prokurorët dhe stafi mbështetës në drejtim të arritjes së rezultateve të kënaqshme për Prokurorinë. Në këtë mënyrë do të rrisim profesionalizmin në punën e prokurorëve dhe besueshmërinë e publikut. Do të kërkojmë nga KPK të rris numrin e prokurorëve dhe stafit profesional. Me numrin aktual nuk mund të arrihet sukcesi i dëshiruar. Nëse është e pa mundur rritja e numrit të prokurorëve për ndonjë arsyeje, duhet transferuar nga prokurorit tjera numër të mjaftueshëm të prokurorëve në një sistem rotacion nga një vit. Në funksion të rritjes së cilësisë në Prokurori, duhet të kërkohet nga SKPK, KPK, ZKSH, Agjencia e Punësimit në Kosovë, Organizatat dhe Institucionet ndërkombëtare në Kosovë, si UNDP, Ambasada Amerikane, etj.. dhe nga Institucionet tjera relevante përkrahje me ndonjë projekt 4 vjeçar për të mbuluar financiarisht pagat për një numër të konsiderueshëm të stafit profesional dhe administrativ. Modalitetet e marrëveshjes apo memorandumit mund të diskutohen. Kjo do të ndihmonte punën cilësore në Prokurori sidomos tek zgjidhja e lëndëve të vjetra të grumbulluara dhe jo vetëm. Me qëllim të sigurimit të punës cilësore në PTH - Mitrovicë në rastet specifike (të komplikuara) të korrupsionit, krimeve ekonomike, drogave, fajdeve, etj.. do të caktojme nga një, dy apo tre prokurorë (pune ekipore), puna e të cilëve do ta përcjellët për së afërmi. Prokurorët nuk do të ndihen të vetmuar në rastet e ndjeshme dhe të komplikuara, do të ndahet përgjegjësia dhe padyshim se, nuk do të mungoj rezultati.

Në funksion të rritjes së cilësisë në punë, do të mbahen kolegji me të paktën dy herë në muaj dhe sipas nevojës më shpesh. Në kolegji me të diskutojmë çdo rast të komplikuar dhe vendimet do të marrim bashkërisht për procedurat e mëtutjeshme. Rezultatet pozitive edhe negative të çdo prokurori do të përmendim në kolegji,

ku do të kenë mundësi që të gjithë prokurorët të japin gjykimin e tyre profesional. Po ashtu, pjesëmarrja e prokurorëve do të jetë e obliguar në kolegji. Për shkak të shumë zhvillimeve që ndodhin për një javë në PTH të Mitrovicë, është e domosdoshme që të mbahen kolegji javore dhe të diskutohen rastet veç e veç, sfidat dhe problemet. Kjo gjithashtu do t'i kontribuon shumë punës cilësore. Fokus të veçantë do t'i kushtohet edhe mbarëvajtjes së seancave gjyqësore në Gjykatën e Mitrovicës dhe Degët e saj. Do të koordinohemi me Kryetarin e Gjykatës dhe me Gjyqtaret Mbikëqyrës, që punët me seancat gjyqësore dhe jo vetëm të ecin sa më mirë dhe pa probleme. Duke e marrë parasysh faktin se, rastet e dhunës në familje janë gjithnjë e më të shpeshta do të caktohen të paktën 2 (dy) prokurorë, të cilët do të jenë përgjegjës dhe bartës të çdo rasti ku paraqitet dhuna në familje. Do të bashkëpunojmë ngushtë me Zyrën për mbrojtjen e viktimave, Qendrën për Punë sociale, IML, Psikiatrinë, Agjencinë e Kosovës për Forenzikë, etj. Do të kërkoj që në prokurori të kemi të punësuar një Psikolog dhe Sociolog më punë të rregullt, të cilët i kanë mungojnë Prokurorisë.

3. Cilat janë planet tuaja për përmirësimin e llogaridhënies së përgjithshme në Prokurorinë tuaj?

Me qëllim që Prokurori Themelore në Mitrovicë, të funksionoj mirë, me efikasitet dhe efektivitet është e domosdoshme llogaridhënia e prokurorëve, e stafit profesional dhe administrativ. Prokurorët janë të obliguar të respektojnë Kushtetutën dhe ligjin dhe të mbrojnë interesin e shtetit dhe të drejtat dhe liritë e njeriut. Prokurorët janë të obliguar të respektojnë Kodin e Etikës Profesionale për Prokuror. Këshilli Prokurorial ka krijuar mekanizma për matjen e performancës së prokurorëve, duke i vlerësuar në mënyrë të detajuar rastet e kryera, hedhjet, pushime, pezullimet, aktakuzat, përfaqësimin e aktakuzave në gjykata dhe mjeteve të ushtruara juridike kundër aktvendimeve/aktgjykimeve. Po ashtu, Prokurorët dhe stafi profesional e administrativ mbahen përgjegjës para Autoritetit kompetent për shkeljet disiplinore. Në këtë kontekst do të kërkojë përgjegjësi nga prokurorët për të kryer detyrat e tyre për të cilat ata janë kompetent, t'i përmbushin në mënyrë profesionale detyrimet e tyre me kushtetutë dhe ligj duke respektuar: Kodin e etikës profesionale; Orarin e punës, pjesëmarrjen në seancat gjyqësore, profesionalizmin e treguar gjatë përfaqësimit të lëndëve, gatishmërinë për të zëvendësuar koleget që kanë arsyeje për mungesën e tyre, efikasitetin, integritetin dhe përgjegjshmërinë.

Deklaroj se përmbajtjen e këtij koncept dokumenti e kam përgatitur vetë dhe jam në dijeni se i njëjti do të publikohet në uebportal.

Nënshkrimi: _____

Datë: _____